



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Për :	Ljiljana Šubarić , Kryetare e Komunës së Graçanicës Milan Dimitrijević , Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Graçanicës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së, Venera Çerkini , Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani , Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 14/04/2022
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Branko Mirić , Zyrtar për Monitorim të Komunave	Nr. 020-323
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	<u>Vendimi Nr. 1691/22 i datës 05.04.2022 i Kuvendit të Komunës së Graçanicës</u>	

E nderuara Kryetare,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenin 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë: 06.04.2022, ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin Nr. 1691/22 (Nr. 18/2022/KG) për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës me datë 05.04.2022.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, kërkon:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendim Nr. 1691/22 (Nr. 18/2022/KG) për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e mbajtur me datë 05.04.2022, ka miratuar *Vendimin Nr. 1691/22 (Nr. 18/2022/KG) për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë.*

MAPL, konstaton së Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës, *është në kundërshtim* me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Ligji Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nuk e parashef dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për bashkësitë fetare për zhvillim të aktiviteteve fetare.

Përveç kësaj, Vendimi Nr. 1691/22 (Nr. 18/2022/KG) për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës, është në kundërshtim me nenin 5 dhe 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si në vijim:

Neni 5 paragrafi 1.3. të Ligjit Nr. 06/L-092, përcakton: të ketë arsyeshmëri të interesit publik apo përfitimit ekonomik të komunës.

Neni 13 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092, përcakton: Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 4 të nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, sqarohet se: Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës. Pronat e paluajtshme të komunës që nuk janë në listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues si dhe nuk kanë miratim paraprak nga Kuvendi i Komunës nuk mund të jepen në shfrytëzim.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetare e Komunës së Graçanicës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Za:	Ljiljana Šubarić , Predsednica opštine Gračanica Milan Dimitrijević , Predsedavajući Skupštine opštine Gračanica	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi , Ministar MALS-a, Venera Çerkini , Zm. Generalne Sekretarke MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani , Zm. Rukovodioca pravnog odeljenja i monitoring opština	Dana: 14/04/2022
Odgovorni službenici:		Br. 020-323
1. Službenik za utvrđivanje pravne procene	Xhevat Tafa , Rukovodilac odseka za monitoring opština	
2. Službenik za izradu pravne procene	Branko Mirić , Službenik za monitoring opština	
Predmet:	Razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine	
Vrsta akta:	<u>Odluka br. 1691/22 od 05.04.2022 Skupštine opštine Gračanica</u>	

Poštovana predsednice opštine,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera kao i Uredbe br. 06/2021 o izmenama i dopunama Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS, dana: 06.04.2022, primio je na procenu zakonitosti Odluku br. 1691/22 (br. 18/2022/OG) o davanju opštinske nepokretne imovine na dugoročno korišćenje, donete od strane Skupštine opštine Gračanica dana 05.04.2022.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), nakon razmatranja zakonitosti predmetnog akta, zahteva:

Ponovno razmatranje zakonitosti akta

Odluka br. 1691/22 (br. 18/2022/OG) o davanju opštinske nepokretne imovine na dugoročno korišćenje, nije u saglasnosti sa važećim zakonodavstvom na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Gračanica na sednici održanoj dana 05.04.2022., usvojila je *Odluku br. 1691/22 (br. 18/2022/OG) o davanju opštinske nepokretne imovine na dugoročno korišćenje.*

MALS konstatuje da Odluka koju je donela Skupština opštine Gračanica, u suprotnosti je sa odredbama Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni nepokretne imovine opštine kao i Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura o davanju na korišćenja i o razmeni opštinske nepokretne imovine.

Zakonom br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni nepokretne imovine, nije predviđeno davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje verskim zajednicama za razvoj verskih delatnosti.

Osim toga, Odluka br. 1691/22 (br. 18/2022/OG) o davanju opštinske nepokretne imovine na dugoročno korišćenje, donete od strane Skupštine opštine Gračanica, u suprotnosti je sa članom 5. i 13. Zakona br. 03/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni nepokretne imovine kao i člana 6. Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura o davanju na korišćenja i o razmeni opštinske nepokretne imovine, kao u sledećem:

Član 5. stav 1.3. Zakona br. 06/L-092, predviđa: da ima opravdanost javnog interesa ili ekonomske koristi opštine.

Član 13. stav 1. Zakona br. 06/L-092, predviđa: opština treba da objavi opšti spisak opštinskih nepokretnih imovina, kao i posebni spisak imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje tekuće godine do 31. decembra, opravdavajući javni interes i ekonomski razvoj opštine.

Odredbe stava 1. i 4. člana 6. Uredbe (VRK) br. 09/2020, pojašnjavaju da: Opština treba da objavi opšti spisak opštinskih nepokretnih imovina, kao i poseban spisak imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje za narednu godinu do 31. decembra, opravdavajući javni interes i ekonomski razvoj opštine. Opštinska nepokretna imovine koja nije u posebnom spisku imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje za narednu godinu kao i koje nemaju preliminarno odobrenje od strane Skupštine opštine, ne mogu se davati na korišćenje.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, zahteva od Skupštine opštine i predsednice opštine Gračanica, da preduzmu konkretne mere radi usklađivanja opštinskog akta sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.